

Drejtoria Arsimore e Filadelfias/ Ekipi Udhëheqës i Drejtorisë për RtII në bashkëpunim me Zyrën e Përfshirjes së Familjes & Komunitetit



Përgjigje për Mësimin dhe Ndërhyrjen dhe Nxënësit që Mësojnë Anglisht

Zyra e Programeve dhe Kurrikulës Shumëgjuhësore është përgjegjëse në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias për kontrollin e nxënësve që nuk e kanë Anglishten gjuhë amtare (ESOL) dhe programeve Dygjuhëshe. Synimi ynë madhor është përshpejtimi i progresit social dhe mësimor të nxënësve ELL duke suportuar dhe monitoruar shkollat dhe duke ju përgjegjur e mbështetur familjet e tyre. Ne dëshirojmë që të gjithë nxënësit, të cilët janë Nxënës që Mësojnë Anglisht (ELLs), përfshirë fëmijët imigrantë dhe të rinjtë, të përvetësojnë gjuhën Angleze, të zhvillojnë arritjet e tyre mësimore në nivel të lartë dhe të jenë në të njëjtin nivel standardesh akademike, që ne presim nga nxënësit tanë.

Zyra e Programeve dhe Kurrikulës Shumëgjuhësore mbështet modelin RTII të Drejtorisë Arsimore në disa rrugë. Meqenëse Nxënësit që Mësojnë Anglisht janë të përfshirë në Tier I për lëndët bazë, ne ofrojmë trajnime në praktikat më të mira mësimore për këta nxënës me mësues nga e gjithë drejtoria. Ne ofrojmë gjithashtu mbështetje për mësuesit në identifikimin e nxënësve që kanë nevojë për ndërhyrje të cilat parashikohen në Tier II dhe Tier III , si dhe në përzgjedhjen e atyre ndërhyrjeve, të cilat janë provuar si të suksesshme me nxënësit që mësojnë Anglisht. Në vazhdim, ne ofrojmë Mbështetës të RTII në Drejtori, me trajnime dhe këshilla në monitorimin e progresit dhe krijimin e planeve mësimore për nxënësit.

Në çdo rrjet mësimor është caktuar një Menaxher Shumëgjuhësh, i cili është i gatshëm të ndihmojë mësuesit, kur ata kanë nevojë për asistencë. Në nivel Drejtorie, ka gjithashtu një specialist të kurrikulës, i cili shërben në ekipin drejtues të RTII.

Pyetjet që Prindërit e Nxënësve që Mësojnë Anglisht, mund të bëjnë rreth RTII.

Cilat janë karakteristikat bazë të RTII për Nxënësit që Mësojnë Anglisht?

Themeli i modelit të RTII është mësimi bazë me cilësi të lartë. Për Nxënësit që Mësojnë Anglisht, kjo përfshin mësim të përditëshme në ESOL dhe lëndët e tjera, në



përshtatje me nivelin e aftësive të tyre në njohjen e gjuhës Angleze. Të gjithë mësuesit përfshijnë në këtë model strategji mësimore dhe mbështetje e cila lehtëson mësimin e gjuhës mësimore dhe sociale, të cilat janë të nevojshme për nxënësit, që të jenë të suksesshëm në klasa.

Si është identifikuar fëmija im për ndërhyrje?

Meqenëse ESOL është lëndë bazë në Pensilvani, kjo e përfshin atë në Tier I, ose në lëndë bazë. Mësuesit janë trajnuar në planifikimin e objektivave të përbajtjes dhe ato gjuhësore, të cilat i ndihmojnë nxënësit të përballin sfidat në mësimin e përbajtjes të lëndës në një gjuhë të re për ta. Përpara se të caktohen për ndërhyrje, ose mbështetje shtesë, mësuesi merr në konsideratë mjedisin kulturor të nxënësit dhe nivelin e përvetësimit të gjuhës. Ata do të përcaktojnë nëse një nxënës po bën përparim të përshtatshëm në përvetësimin e Anglishtes, kur e krahason me një nxënës tjetër që mëson Anglisht dhe nëse nxënësi është i suksesshëm, ose jo, në bazën e ESOL dhe mësimin e lëndës, që përfshin mbështetje dhe mundësi të mjaftueshme për zhvillimin e gjuhës mësimore dhe sociale.

Në rast se një nxënës ngel mbrapa në një prej fushave bazë, mësuesit e ESOL dhe Menaxherët Sumëgjuhësorë mund të rekomandojnë një ndryshim në llojin, ose sasinë e mësimave në ESOL, ose të ofrojnë mbështetje për mësuesin e klasës, në ndihmën ndaj nxënësit, për të qenë i suksesshëm. Ata gjithashtu punojnë me ekipe mësuesish për vendimmarrje, kur kjo është ajo çka duhet për përfshirjen e nxënësit në ndërhyrjet e nivelit Tier II.

Çfarë ndodh në rast se fëmija im ngelet mbrapa në një fushë, kur krahasohet me nxënësit e tjerë në të njëjtin nivel aftësishë gjuhësore?

Në rast se fëmija juaj nuk bën progres të njëjtë si fëmijët e tjerë të të njëjtit nivel, mësuesi i ESOL dhe ai i klasës do të punojnë bashkërisht për të mësuar më tepër për arsyet pse fëmija juaj nuk ka rezultat e pritura. Notat në klasë, vlerësimet bazë, puna e kryer dhe vlerësimet diagnostikuese, mund të jenë objekte të rivlerësimeve. Ata do të marrin në konsideratë faktorët gjuhësorë dhe kulturorë, që mund të krijojnë vështirësi për fëmijën tuaj. Mësuesit më pas do të punojnë për zgjedhjen e ndërhyrjes së duhur për fëmijën tuaj. Ka rëndësi të theksohet, që ndërhyrjet e nivelit Tier II duhet të jenë si shtesë të mësimave që nxënësit marrin dhe nuk duhet të ndërthuren me mësimet e fëmijës tuaj në ESOL.

Si mund të ndihmoj që fëmija im të jetë i suksesshëm në shkollë?

Mos e ndërpritni përdorimin e gjuhës tuaj amtare në shtëpi. Do të ndihmojë më mirë fëmijët tuaj në mësimin e Anglishtes, në rast se ata mund të dëgjojnë, të flasin, të lexojnë dhe shkruajnë në gjuhën tuaj amtare. Leximi i përbashkët me fëmijët dhe diskutimi rreth atyre që lexoni, do t'i ndihmojë ata të bëhen lexues më aktivë.

Është me shumë rëndësi të pyesni për problemet e arsimimit të fëmijës dhe të ofroni këshilla për fëmijën tuaj tek mësuesi i tij. Mësuesi i fëmijës do të vlerësojë njohjen e mëtejshme të fëmijës tuaj dhe do të ndajë informacion me ju për kohën e fëmijës në klasë!

Cilin mund të kontaktoj për mbështetje?

Drejtoria Arsimore mund t'ju mbështesë nëpërmjet përkthyesve në telefon, në takime personale, ose nëpërmjet përkthimit të materialeve të shkruara. Mësuesi i ESOL i fëmijës mund të përgjigjet për pyetjet që lidhen me kohën në klasë, për mësimet e ESOL, ose për aftësitë e përvetësimit të gjuhës. Ju mundeni të kontaktoni nëse është e nevojshme edhe menaxherin shumëgjuhësh të rrjetit tuaj mësimor.